

INTEGRITETI



INTEGRITETI E POLICORË

SEMPER VIGILE

> IPK.RKS-GOV.NET



INSPEKTORATI
POLICOR
I KOSOVËS



POLICIJSKI
INSPEKTORAT
KOSOVA

KUTIA E ANKESAVE KUTIJA ŽALBI

Nëse keni ndonjë ankesë lidhur me sjelljen e zyrtarëve policorë ju mund të vendosni ankesën ose informacionet e tjera në këtë kuti.

Ako imate neku žalbu na rad policiskih službenika možete dostaviti žalbu ili drugu informaciju u ovoj kutiji.

Kontakti/ Kontakt:
044 192 911
Info.ipk@rks-gov.net
Inspektoratipolicor

Të gjitha informacionet do të trajtohen në konfidencialitet të plotë.
Sve informacije biće tretirane strogo poverljivo.

INTEGRITETI



info
zimp.ipk@rks-gov.net

Revista "Integriteti" është botim i Inspektoratit Policor të Kosovës
Divizioni për Marrëdhënie me Publikun dhe Bashkëpunim Ndërkombëtar
Botues: INSPEKTORATI POLICOR I KOSOVËS

Kryeredaktor:
Arbër **BEKA**

Bashkëpunëtorë:
Lulzim **THAÇI**
Shqiponje **SOPI**

Tel: +377 (0) 44 146 696
E-mail: arber.beka@rks-gov.net,
arberbeka@gmail.com, zimp.ipk@rks-gov.net

INTEGRITETI

10-11

Fuqizohet besimi i qytetarëve në IPK



9

Fuqizohet bashkëpunimi në fushën e mbikëqyrjes policore



6

Hasolli - punëtor i dalluar



18-19

IPK shembull për përfshirjen e femrës në sektorin e sigurisë



PËRMBAJTJA

KËNDI I KRYESHEFIT

KULTURA E ORGANIZIMIT DHE STRATEGJIA NË INSPEKTORATIN POLICOR TË KOSOVËS, 4-5

BASHKËPUNIM

IPK SIGURON QË KOSOVA TA KETË NJË SHËRBIM POLICOR PROFESIONAL, 8

IPK

STRUKTURË E RE PËR MË SHUMË EFEKTIVITET DHE EFIKASITET, 14-15

KUTIA E ANKESAVE

IPK LANSON PROJEKTIN “KUTIA E ANKESAVE”, 16-17

DHURIMI I GJAKUT

DHURIMI I GJAKUT - DHURATA MË E ÇMUAR E JETËS, 21

PIKË SHITESË:

Mendimet, komentet, këndvështrimet e shprehura ose të përfshira në përmbajtje të këtij botimi nuk paraqesin medeomos politikat ose vështrimet zyrtare të IPK-së.



Fitim Shishani
Kryeshef i IPK-së

FOTO: INTEGRITETI

Kultura e organizimit dhe Strategjia në Inspektoratin Policor të Kosovës

Bazat e një organizimi të suksesshëm për një organizatë siç është IPK-ja, janë strategjia dhe kultura

Në këtë rast, strategjia e IPK-së 2012-2015, nënkupton aftësinë, përgatitjen, profesionalizmin, dhe objektivitetin tonë për të përmbushur dhe realizuar nevojat e institucionit, për të arritur rezultatet dhe avantazhet, si dhe për të shfrytëzuar sa më shumë pikat e forta të organizimit.

Nga ana tjetër, kultura në këtë rast nënkupton përmbushjen e nevojave të personelit, duke frymëzuar bashkëpunimin kolektiv, qëllim ky i përbashkët për të arritur standardet e dëshiruara të larta profesionale.

Jemi të vetëdijshëm se krijimi i një

kulture të fortë dhe administrimi i mirë i strategjisë dhe kulturës në IPK, do të jenë çdo herë çelës për organizim të suksesshëm të institucionit tonë si mekanizëm mbikëqyrës ndaj Policisë së Kosovës.

Është më se e ditur se menaxherët apo drejtuesit e një institucioni duhet të kërkojnë vazhdimisht rrugë të reja zhvillimi, të identifikojnë pikat e forta dhe të dobëta të organizimit, të motivojnë personelin dhe të përcaktojnë objektivat afatgjatë dhe të mundshëm për tu realizuar.

Menaxhmenti i IPK-së, në vazhdimësi

--	--	--

Ne do të përpilojmë plane e programe afatshkurtra e afatgjata, për luftimin e kriminalitetit të çfarëdo lloji që mund të paraqitet brenda Policisë. Për të arritur këtë, i bindur dua të theksoj se, Inspektorati Policor i Kosovës ka krijuar tashmë një strukturë të aftë organizative, e cila do të realizoj detyrat me përpikëri, do të përpilojë strategji të nevojshme që do të jenë konform nivelit të zhvillimit të dukurive negative brenda Policisë

do të përcaktojë edhe më qartë synimet, detyrat, misionin dhe të drejtat si organ mbikëqyrës ndaj punës së Policisë së Kosovës.

Ne do të përpilojmë plane e programe afatshkurtra e afatgjata, për luftimin e kriminalitetit të çfarëdo lloji që mund të paraqitet brenda Policisë. Për të arritur këtë, i bindur dua të theksoj se, Inspektorati Policor i Kosovës ka krijuar tashmë një strukturë të aftë organizative, e cila do të realizoj detyrat me përpikëri, do të përpilojë strategji të nevojshme që do të jenë konform nivelit të zhvillimit të dukurive negative brenda Policisë.

Përnivelinorganizativ, profesionalizmin, përkulturëndhedokumentetstrategjike me të cilat sot disponon Inspektorati Policor i Kosovës, u jam mirënjohës dhe i falënderohem tërë punonjësve të mi, Policisë së Kosovës, qytetarëve tanë, si dhe partnerëve ndërkombëtar të IPK-së: ICITAP-it Amerikan, EULEKS-it, OSBE-së etj.

Dua të theksoj fare në fund se, dinamika e kohës së sotme, ka karakteristikë ndryshimin, prandaj ata drejtues dhe institucione që dotë dinë të parashikojnë të ardhmen, mund të arrijnë avantazhe në drejtimin dhe kryerjen me sukses të misionit të tyre.

Hasolli - punë

***Integriteti:Z. Hasolli, si ndiheni pas shpalljes suaj punëtori më i mirë i IPK-së ?**

Hasolli: Njeriu nuk ka si të mos ndjehet mirë kur nominohet për një çmim të tillë e aq më shumë kur është pjesë përbërëse dhe kontribuues sado i vogël i sukseseve të mëdha të IPK-së.

Për mua personalisht, kjo është mirënjohja më e rëndësishme dhe më e larta në karrierën profesionale të gjertanishme.

Ndihem i privilegjuar dhe krenar që jam pjesë përbërëse e një organizate siq është kjo e jona e në veçanti prania ime në mesin e këtij stafi të mrekullueshëm që ka IPK-ja.

*** Integriteti:Na thuani cila është rruga për të ardhur deri te ky sukses ?**

Hasolli: Rruga për të arritur deri te ky sukses pa dyshim se është puna e palodhshme për të cilën nevojitet vullnet, përkushtim dhe vendosmëri. Rol kyç në të arriturat e gjertanishme si dhe suksesin e treguar, pa dyshim se ka dhënë përkrahja dhe mbështetja e pa rezervë e menaxhmentit të lartë të IPK-së, bashkëpunimi me Udhëheqësit e Departamenteve dhe Njësive të tjera organizative të IPK-së, e në veçanti përkrahja dhe mbështetja e stafit të Divizionit të cilin unë e udhëheq.

Mund të them me përgjegjësi se kjo mirënjohje ka një rëndësi dhe rol të veçantë për Departamentin dhe Divizionin të cilit i takoj. Kjo mirënjohje do jetë një element motivues për të arritur suksese edhe më të larta edhe në të ardhmen, jo vetëm për mua, por të gjithë kolegët dhe bashkëpunëtorët e mi.



FOTO: ILUZIM THAÇI

ESAT HASOLLI

***Integriteti: Pra, përveç vullnetit kërkohet punë dhe përkushtim. Cilat janë sfidat ?**

Hasolli: Është krejt e natyrshme që gjatë ushtrimit të detyrave dhe përgjegjësive tona hasim edhe në sfida të ndryshme, megjithatë, këto sfida me punë, vullnet, përkushtim, vendosmëri si dhe në bashkëpunim me të gjithë faktorët relevant që kanë të bëjnë me menaxhimin e bux-

hetit dhe financave në kuadër të IPK-së dhe jashtë saj siç janë: Departamenti për Buxhet dhe Financa pranë MPB-së, Departamenti i Prokurimit pranë MPB-së, Departamentet e Buxhetit dhe Thesarit, në kuadër të MF-së, etj., tejkalohen dhe arrihen rezultatet e prekshme.

***Integriteti: Divizioni për buxhet dhe financa ka edhe specifikat e veta.**

ëtor i dalluar

Esat Hasolli. Me profesion ekonomist, me një përvojë profesionale 10 vjeçare. Që nga prilli i vitit 2014 ka qenë i angazhuar në ish Shkollën e Shërbimit Policor të Kosovës (SHSHPK), në Departamentin për Buxhet dhe Financa pranë Misionit për Siguri dhe Bashkëpunim Evropian (OSBE), mision ky i cili ka menaxhuar me SHSHPK, deri në përfundim të vitit 2006. Që nga Janari i 2007 e deri në Qershor të vitit 2012, ka udhëhequr me sukses Sektorin për Buxhet dhe Financa pranë AKSP-së. Nga qershori i 2012-ës, aktivitetin profesional e ushtron me nder pranë Inspektoratit Policor të Kosovës, në cilësinë e Udhëheqësit të Divizionit për Buxhet dhe Financa.



A mund të na tregoni disa prej tyre?
Hasolli: Menaxhimi në sferën e Buxhetit dhe Financave në kuadër të IPK-së; Zbatimi i ligjeve dhe rregulloreve që rregullojnë çështjet buxhetore dhe ato financiare; Menaxhimi dhe planifikimi i planit të zotimeve; Futja e të dhënave në SIMFK; Mbajtja e të dhënave kontabël në sistemin e brendshëm të Divizionit për Buxhet dhe Financa; Përgatitja e pasqyrave vjetore financiare; Procedimi dhe ekzekutimi i të gjitha pagesave; Mbikëqyrja e të gjitha transaksioneve buxhetore; Barazimi i raporteve mbi shpenzimet në mes të IPK-së dhe MF-së; Raportimet mbi shpenzimet, dhe ekzekutimin e buxhetit për Menaxhmentin e IPK-së po ashtu edhe për Departamentet përkatëse pranë MPB-së dhe MF-së; Mirëmbajtja dhe

menaxhimi me fondin e parave të imëta (Petty Cash), janë disa prej specifikave me të cilat unë dhe stafi i Divizionit për Buxhet dhe Financa ballafaqohemi për çdo ditë.

***Integriteti: Cila do të ishte porosia juaj për kolegët e tjerë ?**

Hasolli: Porosia ime për kolegët dhe bashkëpunëtorët e mi, do të ishte që të kryejmë me nder dhe përgjegjësi detyrat dhe obligimet me të cilat jemi të ngarkuar si dhe të angazhohemi në maksimum për arritjen e objektivave të organizatës sonë. Puna, angazhimi dhe performanca jonë individuale dhe ekipore pa dyshim se do të rezultojë në arritjen e objektivave të organizatës.

Intervistoi: Shqiponje Sopi



IPK SIGURON QË KOSOVA TA KETË NJË SHËRBIM POLICOR PROFESIONAL

Bernd Borchardt, Shefi i EULEX-it, e vizitoi Inspektoratin Policor të Kosovës (IPK) ku u prit nga Krye-shefi Ekzekutiv Fitim Shishani.

Gjatë këtij takimi z. Shishani e informoi Borchardtin për punën dhe të arriturat e Inspektoratit Policor të Kosovës në misionin e tij për ta siguruar një shërbim policor llogaridhënës, demokratik dhe transparent në Kosovë.

“Duke shfrytëzuar autorizimet ligjore si agjenci e pavarur në kuadër të MPB-së, ne kemi luajtur rolin tonë për të kontribuar që Policia e Kosovës të jetë një institucion në shërbim të shoqërisë sonë, në shërbim të demokracisë, por, mbi të gjitha, në shërbim të respektimit dhe zbatimit të ligjit në tërë territorin e Kosovës.”, tha Kryeshefi Ekzekutiv i IPK-së z. Shishani. Ai falënderoi Misionin e EULEX-it për përkrahjen e vazhdueshme në zbatimin e



**Kryeshefi Ekzekutiv
i IPK-së, z. Fitim
Shishani priti në takim
shefin e Misionit të
EULEX-it në Kosovë, z.
Bernd Borchardt**

mandateve të saja ligjore.

Bernd Borchardt gjatë takimit e ka vlerësuar bashkëpunimin që e ka misioni me IPK-në, dhe e ka shprehur mbështetjen të cilën ky mision do t'ia jep Inspektoratit në të ardhmen.

“Roli i IPK është shumë i rëndësishëm, pasi që ai shërben si një mekanizëm i kontrollit për Policinë e Kosovës dhe siguron që Kosova ta ketë një shërbim policor profesional dhe sipas standardeve. EULEX-i e ka mbështetur IPK-në që nga viti 2010 dhe ne dëshirojmë të vazhdojmë ta mbështesim atë përmes këshilltarëve në këtë institucion”, tha Bernd Borchardt. Ai e theksoi interesimin e EULEX-in për të gjeturat e IPK-së lidhur me veprimet e PK-së në Zubin Potok më 12 mars 2014.

Z. Borchardt falënderoi Kryeshefin Shishani për njoftimin dhe riafirmoi mbështetjen e Misionit që ai drejton për Inspektoratin Policor të Kosovës.

FUQIZOHET BASHKËPUNIMI NË FUSHËN E MBIKËQYRJES POLICORE



Foto e rastit: zyrtarë të IPK-së, SHKB-së dhe ICITAP

Drejtori i përgjithshëm i Shërbimit të Kontrollit të Brendshëm (SHKB) të Republikës së Shqipërisë z. Arben Skendo, e vizitoi Inspektoratin Policor të Kosovës (IPK) ku u prit nga Kryeshefi Ekzekutiv z. Fitim Shishani.

Gjatë këtij takimi z. Shishani e informoi z. Skendo për punën dhe të arriturat e Inspektoratit Policor të Kosovës duke potencuar rëndësinë e fuqizimit të bashkëpunimit dypalësh në fushën e mbikëqyrjes policore dhe kontrollit të brendshëm.

“Së bashku me agjencinë si motër nga Shqipëria do të angazhohemi drejt fuqizimit të bashkëpunimit në fushën e mbikëqyrjes policore dhe shërbimeve të kontrollit të brendshëm në të dy vendet, me qëllim rritjen e efektivitetit dhe efikasitetit në luftën kundër dukurive negative në radhët e policisë si dhe respektimin e të drejtave dhe lirive të individit” tha Kryeshefi Ekzekutiv i IPK-së z. Shishani.

Edhe Z. Skendo shprehu kënaqësinë



Kryeshefi Ekzekutiv i IPK-së, z. Fitim Shishani priti në takim Drejtorin e Përgjithshëm të SHKB-së z. Arben Skendo

që vizitën e tij të parë si Drejtor i Përgjithshëm i SHKB-së e zhvilloi me Kryeshefin Ekzekutiv dhe punonjës të tjerë të këtij institucioni. Ai shprehu kënaqësinë për arritjet që ka arritur IPK në fushën e mbikëqyrjes policore, në menaxhimin e rasteve në kohë mjaft të shkurtër dhe arritjet tjera që nga koha e krijimit të saj.

“Ky bashkëpunim do t’i hedh themelet së shpejti me nënshkrimin të një memorandumi bashkëpunimi, takime të herë pas hershme në nivel ekspertësh, trajnime të përbashkëta dhe ajo çka është më e rëndësishme shkëmbimi i eksperiencave dhe praktikave më të mira në fushën e mbikëqyrjes policore” – theksoi ndër të tjera Drejtori i Shërbimit të Kontrollit të Brendshëm të Shqipërisë z. Arben Skendo.

Të dy udhëheqësit e dy agjencive si të IPK-së ashtu edhe të SHKB-së shprehën kënaqësinë e tyre që kjo vizitë të jetë vetëm hapi i parë i një bashkëpunimi më të ngushtë midis dy agjencive.



IPK FESTOI PËRVJETORIN E TETË TË THEMELIMIT

Në një ceremoni të organizuar në objektin e IPK-së në Hajvali u shënuar përvjetori i tetë i themelimit të Inspektoratit Policor të Kosovës.

Në këtë ceremoni morën pjesë përfaqësues të lartë të institucioneve vendore dhe ndërkombëtare,

përfaqësues të institucioneve që ndërlidhen me fushën e sigurisë, gjyqësorisë, prokurorisë, përfaqësues ICITAP-i Amerikan, nga Shërbimi i Kontrollit të Brendshëm i Republikës së Shqipërisë etj.

Kryeshefi Ekzekutiv i IPK-së, z. Fitim

Shishani, duke i falënderuar të gjithë pjesëmarrësit e kësaj ceremonie solemne, thekson se OSBE, ka dhënë një rol të rëndësishëm, gjithashtu një rol shumë të madhë ka dhënë që nga viti 2011 dhe po vazhdon të jap ICITAP me seli në Prishtinë. Ai poashtu në këtë





DRITA PEREZIC



FRANK HARRIS

Inspektorati Policor i Kosovës (IPK) – i përgatitur, profesional dhe objektiv

ceremoni solemne potencoi se IPK do të vazhdojë të jetë një agjencion i përgatitur, profesional dhe objektiv: “Rezultatet e IPK-së tanimë janë evidente edhe për qytetarët.

Shpresoj se do të vazhdojmë edhe më tutje bashkërisht të punojmë për profesionalizimin e IPK-së” – theksoi ndër të tjera Kryeshefi Shishani.

Në një fjalim përshëndetës dhe falënderimi për pjesëmarrjen në këtë ceremoni, Frank Harris përfaqësues nga programi i ICITAP-it nga Shqipëria, theksoi se “reputacioni i IPK-së nuk është vetëm në Kosovë por edhe Evropë dhe më gjerë.

Ndërkaq, Drita Perezic nga programi i ICITAP-it në Kosovë, në fjalimin e saj përshëndetës për pjesëmarrësit në këtë ceremoni solemne, potencoi

se për të është nder, privilegj dhe kënaqësi që ka qenë bashkë me IPK-në në këtë shteg të zhvillimit dhe se IPK është duke u bërë më profesional, më disiplinor dhe më i përgatitur.

Si pjesë e ceremonisë u ndanë mirënjohje për institucionet që kanë dhënë ndihmesë në rrugëtimin e suksesshëm të IPK-së si dhe për punëtorë të dalluar në punë dhe aktivitete sportive.



Pamje e koktejit të organizuar me këtë rast



FUQIZOHET BESIMI I

Në një organizim të hapur për media, shoqëri civile, organizata të ndryshme vendore e ndërkombëtare, Inspektorati Policor i Kosovës prezantoi të dhënat e raportit vjetor të saj për vitin 2013.

Ministri Punëve të Brendshme, z. Bajram Rexhepi vlerësoi se IPK-ja edhe gjatë vitit 2013 ka kryer me sukses misionin e saj duke u përkujdesur që ligji është zbatuar në mënyrë profesionale, efektive dhe efikase. “Ministria e Punëve të Brendshme gjatë vitit 2013 ka realizuar disa objektiva sa i përket fuqizimit të IPK-së, si ngritja e kapaciteteve në burimet njerëzore ku janë rekrutuar dhe trajnuar 15 inspektorë të rinj, dhe akomodimi në objektin e ri i cili

ka përmirësuar kushtet dhe mjedisin e punës për stafin e IPK-së” – theksoi Rexhepi.

Duke i përgëzuar për punën dhe angazhimin e menaxhmentit dhe zyrtarëve të IPK-së, Ministri i Punëve të Brendshme Z. Bajram Rexhepi konfirmoi përkrahjen e tij të plotë për fuqizimin dhe funksionimin e pavarur të këtij mekanizmi, i cili do të garantojë qytetarët se Policia e Kosovës ushtron përgjegjësit e saj në përputhje me ligjin dhe në respektim të të drejtave dhe lirive themelore të individit, ashtu si parashihen në Kushtetutën e Republikës së Kosovës dhe Konventat Ndërkombëtare.

Ndërsa Kryeshefi Ekzekutiv i IPK-së,

z. Fitimi Shishani, theksoi se IPK-ja edhe në vitin 2013 ka treguar se është e përgatitur, profesionale, dhe objektive në realizimin e misionit ligjor që ka, “Ne kemi arritur jo vetëm të ruajmë kredibilitetin si institucion profesional, por edhe të kultivojmë një bashkëpunim dhe besim më të madh me qytetarët tanë. Duke shfrytëzuar autorizimet ligjore, ne kemi luajtur rolin tonë, për të kontribuar që Policia e Republikës së Kosovës, të jetë një institucion në shërbim të respektimit dhe zbatimit të ligjit, në shërbim të demokracisë dhe në shërbim të shoqërisë sonë.” – theksoi z. Shishani.

Bazuar në të dhënat e raportit vjetor të IPK-së, në periudhën janar-dhjetor





QYTETARËVE NË IPK


2013, përmes 1064 ankuesve IPK-ja ka pranuar gjithsej 1050 ankesa lidhur me supozimet për shkelje disiplinore/penale të zyrtarëve policorë. Të paraqitur në formë përqindje kjo i bie që 4 % e tërë punonjësve të PK-së ishin nën hetim.

Nga numri i përgjithshëm i ankesave të pranuar dhe të trajtuara nga IPK-ja, 804 ankesa ku ishin të përfshirë si të dyshuar 1048 punonjës të Policisë së Kosovës, janë proceduar për hetime disiplinore në Drejtorin për hetime të Brendshme të Policisë së Kosovës, pasi që ankesat nuk kanë pasur elemente të veprës penale dhe nuk kanë qenë të kualifikuara si shkelje disiplinore të profilit të lartë siç është e paraparë me ligjin për IPK-në.

Ndërsa 246 ankesa janë kualifikuar si kompetencë e IPK-së për hetim ku të përfshirë si të dyshuar ishin 328 pjesëtarë të PK-së, prej tyre 241 raste ishin me elemente të veprës vepale, ndërsa 5 raste kanë qenë raste disiplinore të profilit të lartë. Në vitin 2013 janë 33 punonjës të PK-së më pak të hetuar se sa në vitin 2012”, thuhet në raport.

Ndërsa, nga masat dhe rekomandimet e dhëna nga IPK-ja gjatë vitit 2013 të cilat kanë ardhur si kërkesa dhe nevoja gjatë zhvillimit të hetimeve kanë dalur këto të dhëna.

“16 arrestime nga ana e IPK-së, 46 rekomandime për suspendime nga Kryeshefi Ekzekutiv i Inspektoratit



Policor të Kosovës drejtuar Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Kosovës dhe 2 rekomandime për transfer”, ceket në raportin vjetor të IPK-së.

IPK-ja gjatë vitit 2013 ka realizuar 6 inspektime nga të cilat 4 prej tyre ishin inspektime të rregullta dhe dy të jashtëzakonshme. ku janë inspektuar 81 njësi policore dhe janë inspektuar 142 dosje të ndryshme dhe janë intervistuar rreth 152 zyrtarë policorë të të gjitha gradave dhe pozitave. Inspektimet e rregullta të realizuara gjatë 2013-së në Policinë e Kosovës kanë përfshirë inspektimin e performancës së Njësive Speciale Operative (NJSO), vlerësimi i kushteve materiale dhe aspektit të sigurisë në Qendrat e Mbatjes në Policinë e Kosovës, inspektimi i dhomës së dëshmitave, dhe inspektimi i prokurimit.

Ndërsa inspektimet e jashtëzakonshme ishin vlerësimi i performancës policore gjatë ndërrimit të natës dhe vlerësimi i performancës, gatishmërisë, trajnimeve dhe kushteve të punës në NJSI. Raporti vjetor shtjelloi edhe të dhënat e buxhetit të IPK-së.

Në tabelën dhe grafikun e poshtëshënuar janë të dhënat e ndarjeve finale buxhetore, shumat e shpenzuara, mbetjet dhe realizimi për secilën kategori ekonomike:

Bazuar në të dhënat e prezantuara, objektivat e parapara buxhetore të IPK-së janë realizuar me sukses. Vlen të theksohet se gjatë vitit 2013, është bërë finalizimi i punimeve dhe transferi në objektin e ri të IPK-së, si dhe realizimi me sukses i projekteve kapitale të parapara për vitin 2013.

Lulzim Thaçi

STRUKTURË E PËR MË SHUMË EFEKTIVITET DHE EFIKAS


Struktura organizative është ajo e Scila ka ndikim në shumë aspekte në një organizatë, si në efektivitet ashtu edhe në efikasitet. Në fakt se si duket një strukturë organizative e përcaktojnë faktorë të ndryshëm si madhësia e organizatës, shpërndarja gjeografike e saj etj. Struktura organizative përcakton rolet dhe përgjegjësitë duke rregulluar si rrjedh informacioni në mes të niveleve të ndryshme të menaxhimit.

IPK-ja ka ndryshuar rregulloren për organizimin e brendshëm dhe sistematizimin e vendeve të punës në fund të vitit 2013.

Kjo rregullore përcakton organizimin e brendshëm dhe sistematizimin e vendeve të punës në IPK, strukturën organizative si dhe ndarjen e punëve në kuadër të strukturës organizative.

Menaxhmenti i IPK-së e përshkruan këtë proces si nevojë e kohës dhe plotësim të strukturës së vjetër. Kryeshefi Ekzekutiv i IPK-së Fitim Shishani në një prononcim për revistën “Integriteti” pohon se dinamika e kohës së sotme ka kërkuar një ndryshim të tillë:

“Menaxherët apo drejtuesit e një institucioni duhet të kërkojnë vazhdimisht rrugë të reja zhvillimi, të identifikojnë pikat e forta dhe të dobëta të organizimit, të motivojnë personelin dhe të përcaktojnë objektivat afatgjate dhe të mundshme për t’u realizuar. Dinamika e kohës së



sotme ka karakteristikë ndryshim, prandaj ata drejtues që do të dinë të parashikojnë të ardhmen, mund të arrijnë avantazhe në drejtimin dhe kryerjen me sukses të misionit të tyre”- theksoi Kryeshefi Ekzekutiv Fitim Shishani duke komentuar ndryshimet në rregulloren për organizimin e brendshëm dhe sistematizimin e vendeve të punës.

Struktura e re e IPK-së përfshin zyrën e Kryeshefit Ekzekutiv, Departamentet dhe Divizionet. Kjo strukturë ka një ndarje më ndryshe të Departamenteve prej të cilave ka ndryshim edhe në kompetencat e tyre.

Ndryshimi i kësaj rregulloreje solli nevojën edhe të ndryshimit të akteve tjera nënligjore si dhe procedurat standarde të operimit.

Këtë sfidë IPK-ja është duke e përballuar duke hartuar dhe rishikuar udhëzimet administrative dhe rregulloret që rezultojnë me një ristrukturim të analizuar mirë i cili pritet që të ngris kapacitetet dhe llogaridhënien menaxheriale, qartësinë funksionale të departamenteve, funksionalizimin e nivelit të divizioneve dhe qartësi sa i përket mundësisë së ndërtimit të karrierës afatgjate në agjenci.

RE MË SITET

Struktura e re e IPK-së përfshin zyrën e Kryeshefit Ekzekutiv, Departamentet dhe Divizionet. Kjo strukturë ka një ndarje më ndryshe të Departamenteve prej të cilave ka ndryshim edhe në kompetencat e tyre.





“Kutia e ankesave”- mundësi shtesë për fuqizimin e bashkëpunimit me qytetarë

IPK LANSON PROJEKTIN “KUTIA E ANKESAVE”

Projekti “Kutia e Ankesave” synon fuqizimin e bashkëpunimit me qytetarë duke dhënë një mundësi shtesë për denoncimin e ankesave dhe rasteve të ndryshme me elemente të veprave penale. Ky projekt është në përputhje me vizionin e IPK-së që qytetarët e Kosovës të mund të kenë qasje në shërbim kompetent dhe etik nga IPK-ja dhe Policia e Kosovës. Angazhime të tilla pritet të ndikojnë pozitivisht në ngritjen e nivelit të bashkëpunimit në mes IPK-së dhe qytetarëve të vendit por edhe ngritjes së përgjegjshmërisë së policisë si një institucion vital për sigurinë në Republikën e Kosovës. Si pjesë e projektit janë porositur



kutitë e metalta të cilat janë vendosur në vende publike ku ka frekuentim të madh të qytetarëve. Numri i kutive të metalta do të jetë më i madh se numri i komunave duke llogaritur dhe dëmtimin eventual të ndonjëres prej kutive dhe zëvendësimin e tyre më vonë me kutinë e re.

Vendi ku janë vendosur kutitë janë hapësira ku qytetarët frekuentojnë pa problem duke përfshirë këtu korridorët e Qendrave të Agjencisë së regjistrimit civil si dhe vendkalimet kufitare.

Kryeshefi Ekzekutiv i IPK-së Fitim Shishani, i cili bëri publik para medieve këtë projekt e cilësoi të njëjtin si të suksesshëm:



“Synimi i këtij projekti është që ne të jemi sa më afër qytetarit duke ia lehtësuar mënyrën e komunikimit ose paraqitjes së ankesave potenciale ndaj sjelljeve të zyrtarëve policor”- theksoi Shishani me këtë rast duke potencuar se IPK mbetet e përkushtuar për të siguruar shërbim të mirë për qytetarët duke ofruar një shërbim të kompletuar, konciz e korrekt i cili kryhet me përkushtim e me mirësjellje.

Secilës kuti i është vendosur një fletushkë me mbishkrimin dhe logon e IPK-së duke dhënë detaje se për çka shërbejnë këto kuti.

Në këto mbishkrime janë vendosur edhe numrat e telefonit kontaktues të IPK-së si dhe adresa e ueb faqes dhe rrjetit social.





PAMJE NGA VIZITA E DELEGACIONIT NGA AFGANISTANIT

Femra në Inspektoratin Policor të Kosovës si një nga institucionet e rëndësishme të sigurisë në Kosovë, ka përfaqësim të mirë me një përqindje prej 25% nga totali i punonjësve të Inspektoratit si në nivelin operacional ashtu edhe në atë strategjik

Një delegacion nga Ministria e Punëve të Brendshme e Afganistanit është pritur në objektin e IPK-së në Hajvali nga menaxhmenti i lartë i Inspektoratit Policor të Kosovës (IPK).

Qëllimi i vizitës së këtij delegacioni i kryesuar nga zëvendësministri i Punëve të Brendshme nga Afganistani, z. Ikramuddin Yawar, ishte marrja e praktikave të mira në lidhje me integrimin e femrave në institucionet e rendit dhe sigurisë.

Menaxhmenti i IPK-së i dhanë shpjegime këtij delegacionit lidhur me përfaqësimin e femrës në IPK.

Përndryshe femra në Inspektoratin Policor të Kosovës si një nga institucionet e rëndësishme të sigurisë në Kosovë, ka përfaqësim të mirë me një përqindje prej 25% të totalit të punonjësve të Inspektoratit si në nivelin operacional ashtu edhe në atë strategjik.

Përfshirja e femrës në Inspektoratin Policor të Kosovës është rritur paralelisht me konsolidimin e kësaj agjencie mbështetjen e vazhdueshme edhe nga partnerët ndërkombëtarë siq janë ICITAP, OSBE dhe EULEX.

IPK vazhdimisht mbetet e përkushtuar të punojë në drejtim të përmirësimit dhe promovimit të barazisë gjinore në përputhje edhe me kornizën ligjore e institucionale që rregullon përfshirjen e femrës dhe përfaqësimin e saj në sektorin e sigurisë duke siguruar një mjedis jodiskriminues.

Për të kuptuar më shumë lidhur me pozitën e femrës në IPK stafi i Integritetit intervistoi udhëheqësen e Divizionit të shqyrtimit të ankesave znj. Magribe Sopjani.



IPK SHEMBULL PËR FEMRËS NË SEKTORIN E SIGURISË





MAGRIBE SOPJANI

R PËRFSHIRJEN E FORIN E SIGURISË



*** Integriteti: Zonja Sopjani , ju jeni ndër femrat e angazhuara në IPK. Çfarë mund të na thoni për sfidat në këtë profesion ?**

Sopjani: Prej kohës kur kam filluar të punoj në IPK, kam pasur sfida të ndryshme për faktin që në IPK bëhet një punë shumë e madhe dhe me shumë përgjegjësi kur dihet edhe misioni që e ka IPK, por me vullnet, përkushtim dhe vendosmëri mendoj se ia kam arritur që të dal e suksesshme.

*** Integriteti: Jeni ndër gjeneratat e para të IPK-së? A mund të na i përshkruani dallimet nga gjenerata e juaj me të tanishmet ?**

Sopjani: Në IPK kam filluar të punoj që nga viti 2007. Në gjeneratën time nga njëzet kolegë sa ishim vetëm tri kemi qenë femra. Për ne ka qenë një sfidë e madhe për arsye se ka qenë agjenci e sapo formuar dhe nuk kemi pasur mundësi që të marrim përvoja nga të tjerët lidhur me punën për të cilën edhe ishim të thirrura. Por, me vullnetin e madh që e kishim për punë, mbështetjen nga mbikëqyrësit si dhe nga kolegët që edhe ata ishin sikur ne të ri në këtë profesion kemi arritur që pa problem ti tejkalojmë të gjitha sfidat e punës. Ndërsa tani në IPK është rritur dukshëm numri i punëtorëve të gjinisë femërore. Koleget e reja që kanë filluar të punojnë vitet e fundit në IPK e kanë më të lehtë qasjen në punë për arsye se kanë marrë njohuri lidhur me punën që është bërë tani e disa vite në IPK. Edhe kushtet e punës janë përmirësuar dukshëm vitet e fundit si në aspektin e mirëqenies së punonjësit ashtu edhe të infrastrukturës sidomos tani që jemi vendosur në objektin e rinovuar.

*** Integriteti: Sa është e vështirë të jeni edhe bashkëshorte, nënë dhe person i angazhuar në IPK ?**

Sopjani: Puna në IPK don një angazhim mjaft të madh që të mund të kesh sukses. Nuk e kam pasur të lehtë që ta përballoj punën për arsye se në kohën kur kam filluar të punojë në IPK kam qenë nënë dhe bashkëshorte por me përkrahjen e kolegëve dhe menaxhmentit të IPK-së kam tejkaluar këtë sfidë.

Integriteti: A kanë ndryshuar kushtet e punës sa i përket inkuadrimit të femrës në këtë profesion?

Sopjani: Vet fakti që është rritur numri të punësuarave femra në IPK-len të kuptohet që kushtet kanë ndryshuar në të mirë. Tani jemi numër më i madh, punët dhe përgjegjësitë mendoj se janë më të lehta se sa në kohën kur ishim vetëm tri femra hetuese. IPK-ja tani ka dy femra në pozitën e udhëheqëseve të Departamenteve si dhe dy tjera udhëheqëse të Divizioneve.

Intervistoi: Shqiponje Sopi

TRAJNIM PËR NDRYSHIMET E KODIT TË PROCEDURËS

Në kuadër të trajnimeve të vazhdueshme për personelin e IKK-së, është mbajtur edhe trajnimi me temën “Autorizimet sipas Kodit të Procedurës Penale ”



FOTO: BLERIM RAMA

Qëllimi i këtij trajnimi ishte marrja e njohurive shtesë për punonjësit e IPK-së për risitë që ka sjell ndryshimi dhe plotësimi i Kodit të Procedurës Penale të Kosovës sa i përket autorizimeve policore.

Programi i trajnimit është ideuar dhe mbështetur nga ICITAP, ndërsa për realizimin e tij ishte paraparë bashkëpunimi në mes të ICITAP, Prokurorisë së Shtetit, Inspektoratit Policor të Kosovës dhe Policisë së

Kosovës. Trajnimi është mbajtur në objektin e IPK-së - në sallën e trajnimeve, ku pjesëmarrës në trajnim ishin rreth 30 punonjës të Inspektoratit Policor të cilët ishin në përbërje nga departamentet e ndryshme si Departamenti i Hetimeve, i Inspektimeve, i Hetimeve Speciale, Departamenti për Shqyrtimin dhe Menaxhimin e Ankesave dhe Divizioni për komunikim me publikun dhe bashkëpunim ndërkombëtar.

Trajnimi përfshiu ligjërimin e katër temave të rëndësishme për fushëveprimin e IPK-së duke përfshirë veprimet fillestare hetimore, masat e fshehta, kontrollin dhe sekuestrimin. Përpos njohurive të marra nga ky trajnim është hapur dhe mundësia për thellimin e bashkëpunimit në mes të institucioneve të zbatimit të ligjit më konkretisht në mes të Inspektoratit Policor të Kosovës dhe Prokurorisë së Shtetit.

Lulzim Thaçi



FOTO: BLERIM RAMA



Dhurimi i gjakut - dhurata më e çmuar e jetës

IPK në aksion vullnetar për dhurimin e gjakut

Me rastin e përvjetorit të tetë të IPK-së përveç aktiviteteve të tjera ishte paraparë edhe dhurimi vullnetar i gjakut për fëmijët në nevojë.

Pasi që dita kur u shënua ky përvjetor ishte 1 Qershori që është edhe dita ndërkombëtare e fëmijëve, IPK-ja organizoi një aksion për dhurimin vullnetar të gjakut për fëmijët në nevojë. Ky aktivitet u organizua në bashkëpunim me Qendrën e Transfuzionit të Gjakut të Republikës së Kosovës.

Punonjësit e IPK-së ishin vendosur në radhë duke pritur rendin e tyre në këtë aksion human. Gati gjysma e personelit të IPK-së iu bashkëngjijtën këtij aksioni. Drejtori i Qendrës së Transfuzionit të Gjakut z. Hysen Sadriu që kishte ardhur personalisht të përcillte këtë aksion u shpreh i kënaqur me numrin e dhuruesve si dhe qëllimin e dhurimit:

“Njeriu mund t’i dhuroj njeriut shumë dhurata, por dhurata e gjakut është dhurata më e çmuar e jetës, prandaj një falënderim i posaçëm shkon për të gjithë dhuruesit e gjakut që japin për të shpëtuar jetën e tjetrit” – theksoi z. Sadriu duke i uruar tetë vjetorin e themelimit të gjithë punonjësve të IPK-së.

Në fund të këtij aksioni Qendra e Transfuzionit të Gjakut ndau edhe një mirënjohje për IPK-në.





MIRËNJOHJE PËR SPORTISTËT E DALLUAR

Shumë aktivitete përcollën tetë vjetorin e Inspektoratit Policor të Kosovës e ndër to ishin edhe garat në disiplina të ndryshme sportive si në futboll, pingpong dhe në gjuajtje me armë zjarri.

Punonjës nga departamente të ndryshme të IPK-së kishin filluar përgatitjet më herët për këto aktivitete e disa nga to ishin përkujdesur edhe në përzgjedhjen e emrit për ekipet e tyre.

I tillë ishte rasti me ekipin e Departamentit të Inspektimeve të cilët parësisht emrit të fuqishëm të ekipit të tyre (“Akademikët”) dhe angazhimeve në terrenin sportiv nuk arritën të zënë vendin e parë në futboll por e dëshmuan veten në garën në gjuajtje me armë zjarri ku rrëmbyen një kupë. Foto në vijim japin pamje të aktiviteteve sportive të organizuara me rastin e tetë vjetorit të IPK-së.



FILLON PUNËN FAKULTETI I SIGURISË PUBLIKE

Publikohet konkursi për regjistrimin e studentëve në vitin e parë të studimeve për vitin akademik 2014 - 2015

Akademia e Kosovës për Siguri Publike pas përgatitjeve të nevojshme tanimë ka shpallur konkursin për regjistrimin e studentëve në vitin e parë të studimeve për vitin akademik 2014/2015 në Fakultetin e Sigurisë Publike (AKSP).

Në vitin e parë të studimeve ata kanë planifikuar të regjistrojnë 65 studentë nga Institucionet e Sigurisë Publike, sipas kuotës së përcaktuar në drejtimet e programit të studimit bachelor në sigurinë publike duke ndarë pesë vende për Inspektoratin Policor të Kosovës në drejtimin policor.

Si kushte për regjistrim në vitin e parë përveç diplomës së shkollës së mesme dhe punësimit në Institucionet e Sigurisë Publike, kërkohen edhe së paku tre vite përvojë pune në agjencitë përkatëse të sigurisë publike.

Për studentët që vijojnë studimet në programin bachelor në Akademinë e Kosovës për Siguri Publike, mënyra e studimit do të jetë e ndarë në dy pjesë, pjesa teorike (ligjëratat) vijohet në Akademinë e Kosovës për Siguri Publike gjatë tri ditëve të punës brenda javës, në ditët e hënë e martë dhe e mërkurë dhe pjesa praktike (Internshipi) vijohet pas përfundimit të ligjëratave, më së largu deri më 30 shtator të çdo viti përkatës akademik në vendet e caktuara të punës në institucionet përkatëse konform plan-programit mësimor.

Këto studime bachelor për pjesëtarët e agjencive të sigurisë publike ofrohen falas dhe pa shkëputje nga puna.





INSPEKTORATI POLICOR I KOSOVËS
POLICIJSKI INSPEKTORAT KOSOVA
POLICE INSPECTORATE OF KOSOVO

**Të përgatitur,
profesional
dhe objektiv**

Tel: 044 192 911

info.ipk@rks-gov.net / ipk.rks.net